



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 39 regjistër (JR)

Datë 07.12.2018

Nr. 24 i vendimit

Datë 08.10.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Luan Daci	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ardian Hajdari	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 08.10.2019, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES:	Subjekti i rivlerësimit Sotiraq Lubonja, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.
OBJEKTI:	Shqyrtimi i vendimit nr. 68, datë 08.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
BAZA LIGJORE:	Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet A, Ç, D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/21016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e faktit

1. Z. Sotiraj Lubonja është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar rivlerësimit kalimtar *ex officio*. Subjekti i rivlerësimit është përfshirë në listën e subjekteve që janë vlerësuar me përparësi, për shkak të qenies anëtar zëvendësues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, sipas përcaktimit të nenit 284, pika 9 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
 2. Pas dorëzimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit/*vetting*, datë 27.01.2017, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), ky i fundit ka përgatitur aktin e kontrollit nr. {***} prot., datë 12.01.2018, në bazë të të cilit rezulton se ka konstatuar sa më poshtë:
 - a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) ka kryer deklarim të rremë;
 - d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
- 2.1. Pas veprimeve verifikuese, ILDKPKI-së i rezultoi:
- i) fshehje nga ana e subjektit të rivlerësimit e kërkesës për legalizim të ndërtesës 2 kate + papafingo në lagjen {***}, rr. “{***}”, Korçë, në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2006 në ILDKPKI;
 - ii) fshehje e sipërfaqes totale të banesës në lagjen {***}, rr. “{***}”, Korçë (të pjesës së dhuruar + shtesës së ndërtuar) dhe deklarim i rremë i shumës së investuar për ndërtimin pa leje, si dhe mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për shumën e investuar për shtesën dhe mungesë burimesh të ligjshme financiare, gjykuar nga sipërfaqja e saj, dhe se referuar ALUIZNI-t, sipërfaqja shtesë për banim është 395 m², ndërkohë që rivlerësimi i pasurisë i vitit 2016, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, është bërë për truall me sip. 173 m² dhe ndërtesë me sip. 62 m²;
 - iii) ndërtimi i paligjshëm i shtesës së kryer në banesën e ndodhur në lagjen {***}, rr. “{***}”, bie ndesh jo vetëm me ligjin penal shqiptar, pasi ndërtimi i paligjshëm parashikohet si veprë penale në nenin 199/a të Kodit Penal, por edhe me funksionin e subjektit të rivlerësimit, si dhe kompromenton shumë rëndë figurën e tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë;

- iv) deklaram i rremë i subjektit të rivlerësimit në lidhje me shumën prej 3.000.000 lekësh dhuruar nga nëna dhe që është përdorur nga bashkëshortja për investim në bono thesari, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar burimin financiar të nënës, dhe as të dhuruesve, dhe se kjo shumë e investuar në vitin 2013 në bono thesari, nuk është e justifikuar me burime të ligjshme financiare nga ana e subjektit të rivlerësimit;
 - v) deklaram i rremë në lidhje me burimin e krijimit të bonove të thesarit në shumën 25.000 USD në vitin 2007, pasi dokumentacioni i paraqitur për vjehrrin e subjektit, z. G. Gj., me banim në ShBA që nga vitit 1999, nuk provon mundësinë e tij financiare për shumën e dërguar fillimisht në {***} Bank, prej 25.000 USD, në emër të vajzës së tij në vitin 2005, mungesë burimesh të ligjshme financiare për të krijuar depozitën në vitin 2005, e më pas kalimin në bono thesari;
 - vi) nuk është dokumentuar mënyra e dërgimit nga ShBA-ja e shumës 5000 USD nga z. G. Gj. për z. P. dhe z. I. L. në vitin 2015.
3. Pas dorëzimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të deklaratës për kontrollin e figurës, datë 27.01.2017, pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), kjo e fundit ka përgatitur raportin¹ mbi kontrollin e figurës nr. {***} prot., datë 02.11.2017, pas informacioneve të ardhura nga {***}, {***}, dhe {***}, nga ku rezulton se:
- a) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë;
 - b) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete;
 - c) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar;
 - ç) është konstatuar përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
4. Pas dorëzimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, datë 27.01.2017, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), rezulton se kjo e fundit ka përgatitur raportin për analizimin e aftësive profesionale nr. {***} prot., datë 20.02.2018, duke iu referuar kritereve të *aftësive profesionale*, të *aftësive organizative*, të *etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale* dhe të *aftësive personale dhe angazhimit profesional*, bazuar në 3 (tri) dokumentet ligjore të përpiluara nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit dhe të dhënat e dokumenteve të tjera bashkëlidhur formularit të vetëdeklaramit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në 5 (pesë) dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe bazuar në të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 68, datë 08.10.2018, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë”, pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

¹ Deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 11.04.2018.

- a) nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës; dhe
- c) ka një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

6. Për vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues i Komisionit ka arritur në konkluzionet e mëposhtme.

- a) Ka rezultuar se referuar nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij, duke mos paraqitur saktë kohën kur është kryer ndërtimi i shtëpisë, sipërfaqen reale të shtesës (ndërtim pa leje) dhe kërkesën për legalizimin e objektit të ndërtuar pa leje.
- b) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ai ka treguar një sipërfaqe tjetër, nga ajo reale, për banesën e tij në Korçë, duke kryer fshehje të pasurisë. Ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e ndërtuar, si dhe ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën e ndërtimit të pronës.
- c) Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurash për shpenzime të kryera në jetën e tij (udhëtime), por edhe për blerjen e disa pasurive të cituara në vendim, të ardhura të krijuara nga dhurimet nga vjehri dhe vjehrra, por edhe kunati, dhe megjithëse subjekti i rivlerësimit paraqiti një dokumentacion lidhur me të ardhurat vjetore të tyre në ShBA dhe Shqipëri, trupi gjykues nuk u bind lidhur me mundësitë financiare të dhuruesve, pasi në asnjë rast të shpjeguar në vendim, subjekti nuk mundi të provojë se ato para kishin ardhur në ndonjë formë që të mund të provohej përfitimi i tyre (transferte bankare, deklaram në kufi) dhe ato dhurime krijuan dyshime për trupin gjykues.
- ç) Trupi gjykues e konsideron si deklaram të rremë burimin e krijimit të dhuratave të përfituara nga vjehri dhe vjehrra, duke konstatuar mungesë burimesh financiare të ligjshme për të krijuar shumat e dhuruara, si dhe mungesë të dokumentacionit ligjor provues për realizimin e dhurimeve.
- d) Ka mbetur e padokumentuar mënyra e dërgimit nga ShBA-ja e shumës 5.000 USD për djemtë P. dhe I. L., në vitin 2015, si dhe pamundësia financiare e z. G. Gj. për dhurimin e shumës prej 25.000 USD në vitin 2005.
- dh) Mbështetur në analizën financiare të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se nëna ka qenë në pamundësi për realizimin e të ardhurave të deklaruara të kursyera, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se deri në vitet 2002 - 2003, të ardhurat familjare kanë shërbyer tërësisht për ndërtimin e shtëpisë në Korçë, po ashtu edhe faktin se vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime ndër vite.
- e) Trupi gjykues, bazuar në provat që disponoi, në vlerësimin në tërësi të dhuratave të përfituara dhe mënyrës se si ato janë realizuar, nuk u bind lidhur me ligjshmërinë e dhurimeve, duke i konsideruar ato si deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

- ë) Mbështetur në analizën financiare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur likuiditete të mjaftueshme për blerjen e makinës tip “Mercedes Benz” më datë 14.04.2005, prodhim i vitit 1999.
- f) Trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit duket sikur ka pasur mundësi financiare për blerjen e pasurisë apartament në {***}, Tiranë, porse burimi i krijimit të bonove të thesarit kanë qenë dhurimet e vjehrrit dhe të nënës, të cilin trupi gjykues nuk e ka pranuar si burim të ligjshëm.

III. Shkaqet e ankimit

- 7. Kundër vendimit të Komisionit paraqiti ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), subjekti i rivlerësimit Sotiraq Lubonja, me të cilin kundërshtonte konkluzionet e Komisionit lidhur me konstatimin e situatës faktike dhe mënyrën e zbatimit të ligjit për këto fakte, duke parashtruar në ankim shkaqet dhe arsyet e kundërshtimit të këtyre konkluzioneve të Komisionit.
- 8. Në lidhje me provueshmërinë e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë shtëpi banimi në Korçë, me sip. truall ndërtimi 61 m², me dy kate + papafingo, me adresë në lagjen {***}, rr. “{***}”, nr. {***}, pjesa takuese 66,66 %, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka dokumentuar me kontratë dhurimi nga z. N. K. dhe znj. K. L. (K.), që janë trashëgimtarë të z. K. K.. Në vijim parashtron se nëna e tij, znj. F. L., ka bërë një shtesë të shtëpisë, ndërtim i cili është vetëdeklaruar tek ALUIZNI.
 - 8.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka shkelur nenin 199/a të Kodit Penal sepse në vitin 2008 ka hyrë në fuqi kjo dispozitë, dhe ka parashtruar se ndërtimi është bërë në vitet 1995 - 2002.
 - 8.2. Në përmbajtje, sipas subjektit të rivlerësimit, posedimi me pronësinë dhe përdorimin shkojnë njëtrajtësisht, dhe ai ka paraqitur në deklaratën e vitit 2003 faktin që disponon një shtëpi dy kate, plus papafingo, sepse në vitin 2002 është pronar i një të tretës pjesë të pasurisë (jo të gjithë shtëpisë), e cila është pjesë funksionale e daljes nga shtëpia në rrugë dhe më pas është bërë pronar në vitin 2007 me dy kontrata dhurimi. Pra, në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka fshehur pasuri sepse nuk e ka pasur, por njëkohësisht nuk është deklarim i pasaktë sepse ka paraqitur atë që ka pasur në lidhje me legalizimin e objektit pa leje, për të cilin që nga dita e aplikimit dhe deri më sot nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, ALUIZNI. Në lidhje me burimin e të ardhurave, në parashtruesat e datës 02.10.2019, lidhur me shkaqet e ankimit, pretendon se ndërtimi i shtëpisë është bërë nga paga e tij, e bashkëshortes, por edhe të atit që ka ndërruar jetë në vitin 1997, të nënës që ka ndërruar jetë në vitin 2012. Në lidhje me shtesën e objektit, shprehet se e ka sqaruar qartas që shtesa e objektit është bërë nga viti 1995 deri në vitin 2002, dhe se nuk ka vend për asnjë lloj aludimi nga Komisioni.
 - 8.3. Nuk ka deklarim të rremë, sipas subjektit të rivlerësimit, lidhur me ndërtimin e pronës, sepse ka paraqitur prova të mjaftueshme për këtë lloj ndërtimi dhe se ndërtimi pa leje në tokën e dikujt tjetër nuk ka qenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse ka shpjeguar marrëdhëniet me

ish-pronarët, ka marrë miratimin e tyre, ka shpjeguar marrëdhënien familjare dhe nuk ka gjetur organe kompetente të shtetit shqiptar për leje ndërtimi, dhe për sa kohë shteti nuk i përgjigjet individit brenda 30 ditëve (ditë pune), duhet të ekzekutohet nga individ.

9. Në lidhje me udhëtimin në vitin 2008 së bashku me familjen në ShBA, udhëtimet gjatë viteve 2010 - 2016, së bashku apo veç e veç me pjesëtarët e familjes në ShBA, dhurimet e vjehrrit, vjehrrës, kunatit dhe të nënës, si dhe në lidhje me bonot e thesarit, subjekti i rivlerësimit pretendon se burim i krijimit të tyre kanë qenë dhurimet e vjehrrit dhe të nënës, burim të cilin trupi gjykues i Komisionit nuk e ka pranuar si të ligjshëm. Në lidhje me mundësitë financiare të dhuruesve, vjehrrit, vjehrra dhe bashkëshortja e kunatit, subjekti i rivlerësimit pretendon se çdo lloj transferte bankare ose deklarim *cash* në kufi, ligji shqiptar të detyron, por edhe të dënon në rast se e kalon shumën prej 10 mijë dollarësh për person, dhe për pasojë nuk është e bazuar bindja e Komisionit se janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin. Prerjet e biletave për udhëtimin, sipas subjektit të rivlerësimit, janë bërë prej llogarisë së bashkëshortes të kunatit të tij, ato ndodhen në ILDKPKI dhe janë të verifikueshme.

9.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, burimi i krijimit të dhuratave të përfituara nga prindërit e bashkëshortes, është jo vetëm i ligjshëm financiarisht, por dhe i provuar me dokumente të cilat janë prokura e prindërve të bashkëshortes për të tërhequr pensionet, dokumentet e Postës Shqiptare për t'i sjellë këto vlera dhe deklarata noteriale e prindërve të bashkëshortes që këto para do qëndrojnë pranë familjes sonë.

9.2. Në lidhje me mosdokumentimin e dhurimit nga prindërit e bashkëshortes së shumës prej 5000 USD në favor të fëmijëve të tij, z. P. L. dhe z. I. L., subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk mund të konsiderohet si tejkalim i aftësive paguese, sepse ka vërtetuar në mënyrë bindëse, me dokumente, pagat e marra dhe tatimet e paguara, dhe njëkohësisht ka depozituar edhe dokumente të ShBA-së, që vërtetojnë se në vitin 2012 vjehrrit ka blerë një makinë 27800 dollarë, të ndërruar në vitin 2013 me 8000 dollarë, gjë që tregon se kanë disponuar mbi bazën e punës çdo të ardhur materiale që vlerëson pritshmëritë.

10. Në lidhje ligjshmërinë e krijimit të pasurisë automjet, tip "Mercedes Benz", prodhim i vitit 1999, blerë më datë 14.4.2005, vlera 900.000 lekë + 325.000 lekë taksa doganore, pjesa që zotëron 100%, subjekti i rivlerësimit, për mungesën e likuiditeteve për blerjen e kësaj pasurie, parashtron se ka filluar punë më 1.8.1985 dhe ka blerë makinë më datë 14.4.2005, ndërkohë që paga e tij është e përcaktuar por e padeklaruar nga shteti shqiptar, dhe se blerja është kryer kur u rritën fëmijët dhe kur ishin të gjitha mundësitë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

11. Për sa i përket juridiksionit të Kolegjit, në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e

tyre, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Sotiraq Lubonja, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet e subjekteve të rivlerësimit ndaj vendimeve të Komisionit, sipas përcaktimeve të nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

12. Ankuesi, subjekti i rivlerësimit, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
13. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim ligji “nr. 49/2012”), shqyrtimi i vendimit të Komisionit u zhvillua mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, pasi trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi e plotë dhe e saktë gjendja faktike e konstatuar nga ana e trupit gjykues të Komisionit. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi që vendimi i Komisionit të jetë bazuar në shkelje të rënda procedurale.

13.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në lidhje me aktet që shoqërojnë ankimin dhe të kërkuara prej tij që të merren në cilësinë e provës, çmon se sipas parashikimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte në shqyrtimin e çështjes nga Komisioni, ndërkohë që në përmbajtje, trupi gjykues i Kolegjit vëren se synohet të përcaktohet gjendja e fakteve dhe e rrethanave që kanë lidhje me kriterin e aftësive profesionale, që është jashtë objektit të gjyqimit², se janë fakte të provuara dhe se edhe

² Shih: ankim, dt. 27.10.2014, ankues “Sotiraq Lubonja”, kundër “Projekt - Aktivlerësimit të gjyqtarit Sotiraq Lubonja për periudhën 1.1.2007 - 31.12.2009”, drejtuar “Këshillit të Lartë të Drejtësisë”; shkresë nr. {***} prot., dt. 21.1.2015 e KLD-së, me lëndë “Njoftim vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, drejtuar “z. Sotiraq Lubonja, gjyqtar në Gjykatën e Apelit”, sipas së cilës përmbledhtazi: “[...] bashkëlidhur gjeni vendimin nr. {***}, dt.2.10.2015, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”; vendim nr. {***}, dt. 2.10.2015, “Mbi vlerësimin përfundimtar mirë të gjyqtarit Sotiraq Lubonja për periudhën 1.1.2007 - 31.12.2009”, sipas të cilit, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur si dhe projektaktin përfundimtar të vlerësimit të përgatitur nga kryeinspektori i KLD-së, vendosi: “1. Të vlerësojë mirë gjyqtarin Sotiraq Lubonja për periudhën kohore 1.12007 - 31.12.2009 sipas tabelave “Vlerësimi përfundimtar”, bashkëlidhur”; shkresë nr. {***} prot., dt. 23.9.2013, e KLD-së, me lëndë “Njoftim vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, drejtuar “z. Sotiraq Lubonja, Gjykata e Apelit”, sipas së cilës përmbledhtazi: “[...] ju njofton se me vendimin nr. {***}, dt. 8.9.2013, “Mbi vlerësimin përfundimtar shumë mirë të gjyqtarit Sotiraq Lubonja për periudhën 2005-2006” të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ju jeni vlerësuar shumë mirë për punën si gjyqtar për periudhën 2005-2006”; shkresë “Ankesa të ardhura për gjyqtarin Sotiraq Lubonja” (gjithsej 13); procesverbal i KLD-së nr. {***} prot., dt. 6.9.2013, sipas së cilës përmbledhtazi: “[...] sot, më dt. 4.9.2013, ora 13:00, në ambientet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ne inspektorët M. P. dhe Q. Z., me rastin e njoftimit të projektaktit përfundimtar të vlerësimit të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Korçë, zotit Sotiraq Lubonja, për periudhën 2005-2006, i dorëzojmë atij këto dokumente: 1). projektakti përfundimtar i vlerësimit të gjyqtarit Sotiraq Lubonja; 2). vendimet e cenuara të gjyqtarit Sotiraq Lubonja; 3). ankesa të ardhura për gjyqtarin Sotiraq Lubonja; 4). pjesëmarrja në seminarin e organizuar nga Shkolla e

nëse konsiderohen të vërteta, ato nuk ndikojnë në marrjen e vendimit³, sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 6, germat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

13.2. Në lidhje me aktet bashkëlidhur parashtrimeve të datës 02.10.2019, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht konstaton se ato janë paraqitur pas ankimit dhe se në kundërshtim me nenin 47 dhe me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte në shqyrtimin e çështjes nga Komisioni. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se synohet të përcaktohet gjendja e fakteve dhe e rrethanave që kanë lidhje me kriterin e aftësive profesionale, që është jashtë objektit të gjykimit⁴, por edhe se synohet të provohen fakte të provuara⁵ apo që nuk sjellin fakte të reja për kriterin e pasurisë, të cilat nuk

Magjistraturës për gjyqtarin Sotiraq Lubonja”; listë e të ftuarve dhe pjesëmarrësve në seminarin “Hierarkia e normave, aktet normative dhe marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese, Kursi I 01 21 - 22 shkurt 2006”, [...] subjekti i rivlerësimit nuk është listë [...]; listë e të ftuarve dhe pjesëmarrësve në seminarin “Trajtimi mbi të Drejtën Europiane materiale”, Kursi J01 15 - 16 dhjetor 2005” [...] 6. Sotiraq Lubonja [...]; listë e të ftuarve dhe pjesëmarrësve në seminarin “Ligji i ri për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe regjistrimi i pasurive, 14 prill 2006 Korçë” [...] 26. Sotiraq Lubonja [...]; listë e të ftuarve dhe pjesëmarrësve në seminarin “Regjimet pasurore martesore, 19 - 20 prill 2006, Korçë”, [...] nuk është në listë [...]; listë e të ftuarve dhe pjesëmarrësve në seminarin “Regjimet pasurore martesore, 3 - 4 maj 2006, Korçë” [...] 10. Sotiraq Lubonja [...]”.

³ Shih: vërtetim nr. {***} prot., dt. 16.11.2018, i Gjykatës së Apelit Korçë, sipas të cilit, përmbledhtazi: “[...] z. Sotiraq Lubonja ka përfutuar të ardhurat vjetore për periudhën e punës 16.12.2001 - 8.10.2018 nga detyra si gjyqtar i Gjykatës të Apelit Korçë [...] paga neto 19764785 lekë, dieta 1201862 lekë, shpërblime 311211 lekë”.

⁴ Shih: shkresë e z. K. J., datë 18.05.2011, drejtuar kryetarit të Gjykatës së Rrethit Korçë, refuzimin e pranimit si të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë; dëftesë pjekurie e z. Sotiraq Lubonja, shkolla e mesme e përgjithshme “R. Q.”, Korçë, refuzimin e pranimit si të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë; librezë e studentit Sotiraq Lubonja, Fakulteti Shkencave Politike Juridike - Universiteti i Tiranës, refuzimin e pranimit si të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë; listë e rezultateve të provimeve që i bashkëngjitet diplomës së z. Sotiraq Lubonja, Fakulteti Shkencave Politike Juridike - Universiteti i Tiranës, refuzimin e pranimit si të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë; diplomë e z. Sotiraq Lubonja, Fakulteti Shkencave Politike Juridike - Universiteti i Tiranës, refuzimin e pranimit si të panevojshme, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë; vendim i KLD-së nr. {***}, datë 02.10.2015, refuzimin e pranimit si të panevojshëm, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë; vlerësim përfundimtar i KLD-së për gjyqtarin Sotiraq Lubonja për periudhën 01.01.2007 - 31.12.2009, refuzimin e pranimit si të panevojshëm, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2916, pasi nuk lidhet me kriterin e pasurisë.

⁵ Shih: kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.2002; kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2007; testament nr. {***} rep., datë 15.07.2011; inventar ILDKPKI nr. {***} prot., datë 08.05.2015; akt vlerësimi ing. A. R., datë 12.07.2007; shkresë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve nr. {***} prot., datë 09.08.2017; shkresë nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Korçë nr. {***} prot., datë 26.05.2017; vërtetim nga Gjykata e Apelit Korçë nr. {***} prot., datë 16.11.2018; prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.07.1999; prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.07.2005; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} vol. akt., datë 28.12.1994; mandatpagesë nga {***}, datë 25.11.1997; mandatpagesë nga Banka e Shtetit Shqiptar, datë 19.08.1997; mandatpagesë nga Banka e Shtetit Shqiptar, datë 20.10.1997; mandatpagesë nga {***}, datë 25.11.1997; mandatpagesë nga Arka e Kreditit {***}, datë 17.10.1996; mandatpagesë nga Arka e Kreditit {***} Korçë, datë 26.06.1997; mandatpagesë nga {***}, datë 16.08.1996; mandatpagesë nga {***} Korçë, datë 11.02.1997; mandatpagesë nga {***} Korçë, datë 11.02.1997; mandatpagesë {***}, datë 29.06.2005; veprim arke {***}, datë 30.05.2005.

përbëjnë provë⁶ në kuptim të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 6, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

13.3. Në lidhje me aktet bashkëlidhur parashtrimeve të datës 03.10.2019, trupi gjykues i Kolegjit fillimisht konstaton se ato janë paraqitur pas ankimit dhe se në kundërshtim me nenin 47 dhe me nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte në shqyrtimin e çështjes nga Komisioni, kurse në vijim çmon se ato nuk përbëjnë provë në kuptim të ligjit, por edhe nëse konsiderohen të vërteta faktet që synohet të provohen, ato nuk ndikojnë në marrjen e vendimit⁷, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 1, germa “c”, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

14. Trupi gjykues i Kolegjit e shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit Sotiraq Lubonja, së bashku me parashtrimet në lidhje me ankimin, bazuar në nenin F, paragrafët 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 65/1 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012.

Vlerësimi i shkaqeve materiale të ankimit

15. Në lidhje me shtëpinë e banimit në Korçë, me sip. truall ndërtimi 61 m², me dy kate + papafingo, me adresë në lagjen {***}, rr. “{***}”, nr. 7, pjesa që zotëron 66,66%, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e arritur për *fshehje* dhe *deklarim të rremë*, duke e vendosur theksin te motivimi që kanë pasur palët dhuruese për pjesët takuese. Në fakt, hetimi administrativ i Komisionit është përqendruar në pamundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme të kostos së ndërtimit të objektit ekzistues dhe zgjerimin e këtij objekti përtej asaj çka përmbanin kontratat e dhurimit, duke vlerësuar njëkohësisht edhe faktin e kryerjes nga ana e subjektit të rivlerësimit, të një ndërtimi të paligjshëm në zgjerim të sipërfaqes ekzistuese (truall dhe ndërtesë).

15.1. Sipas deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit - *vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit” është deklaruar nga subjekti: “shtëpi banimi në Korçë, me sip. truall ndërtimi 61 m², me dy kate + papafingo, me adresë lagja {***}, rr. “{***}”, nr. {***}, Korçë, fituar me kontratë dhurimi nr. {***} rep. nr. {***} kol., dt. 9.7.2002, për 1/3 pjesë të pasurisë, si dhe me kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 12.7.2007, në lidhje me 1/3 pjesë të dhurimit, kontrata këto të dhuruesve N. K. K. dhe M. Sh. (K.)”, kurse në rubrikën “Vlera me shifra dhe me fjalë”, është deklaruar: “e deklaruar në vitin 2003 - 2500000 lekë - proces regjistrimi për shkak të regjistrimit pilot financiar nga {***} - rivlerësimi i kryer mbi këtë raporte pronësie kryer nga eksperti P. T., bazuar në ligjin nr. 81/2016, dt. 20.7.2016, “Për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme”, vlera aktuale sot 4397.592 lekë”, dhe në rubrikën “Pjesa në %”, është deklaruar: “66,66%”.

⁶Shih: publikim i Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë - Kumtesa dhe konkluzione të Konferencës 04.05.2012, me titull “Kush i gjykon gjyqtarët”, me autor Ledi Bianku, refuzimin e pranimit si të panevojshëm, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk përbën provë.

⁷Shih: shkresë me dorëshkrim, pa ekstremitete, datë, nënshkrim apo të dhëna për hartuesin e shkresës, në përmbajtjen e së cilës listohen pajisje të ndryshme elektrike; shkresë me dorëshkrim, pa ekstremitete, datë, nënshkrim apo të dhëna për hartuesin e shkresës, në përmbajtjen e së cilës përmenden punime të mbetura pa u përfunduar dhe të tjera të përfunduara.

15.1.1. Nga kontrata e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 9.7.2002, rezulton se dhuruesi N. K. (N.K.), bashkëpronar me M. Sh. dhe K. L., i dhuron pranuesit të dhurimit Sotiraq Lubonja 1/3 (një të tretën) pjesë takuese, pa asnjë kusht dhe kundërshpërblim, ndërkohë që nga kartela e pasurisë së paluajtshme, nr. pas. {***}, zk {***}, vol. {***}, fq. {***}, sip. truall 173 m², sip. ndërtesë 62 m², rezulton: “në sip. ndërtimore shënohet sip. 62 m² sipas dokumentit të VKKP nr. {***}, datë 05.01.1996 - sip. 131 m² rezulton të jetë e ndërtesës për të cilën kërkohen dokumentet ligjore për regjistrimin e saj - ndërtim pa leje”.

15.1.2. Nga kontrata e dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 12.7.2007, rezulton se dhuruesja K. L. – K., e përfaqësuar nga N. K. (N. K.), bashkëpronare me M. Sh. dhe Sotiraq Lubonja, i dhuron pranuesit të dhurimit Sotiraq Lubonja 1/3 pjesë të pandarë të ndërtesës + truall, ndodhur në Korçë, rr. “{***}” (sot “{***}”) pas nr. {***}, zk {***}, vol. {***}, fq. {***}, me sip. të ndërtuar 62 m², sip. trualli 173 m².

15.2. Në deklaratën fillestare të vitit 2003, në rubrikën “Përshkrimi”, është deklaruar nga subjekti: “shtëpi banimi, ndërtim në vitin 1995, ndërtuar vetëm shtesa”, vlefëta “2,5 milionë”, pjesa që zotëron “33,33%”, vendndodhja lagja {***}, rr. “{***}”, nr. {***}, Korçë, ndërkohë që te rubrika “Burimi”, është deklaruar: “kontratë dhurimi për 1/3 pjesë të pandarë të shtëpisë nga N. K. për Sotiraq Lubonjën, me sip. trualli 108 m², dhe ndërtimi⁸ 61 m², me dy kate + papafingo, me ndërtimet deri në vitin 05.07.2002 - kontrata ka nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.07.2002, në proces regjistrimi për shkak të regjistrimit pilot për lagjen ku banoj, financuar nga {***} - noter A. A., Korçë”.

15.3. Pas verifikimit në terren nga Drejtoria e ALUIZNI-t Korçë, nga procesverbali i verifikimit, ka rezultuar se ndërtimi informal i banesës me 3 kate të Sotiraq Lubonja, i përfshirë në procedurat e legalizimit me vetëdeklarim, ka këto të dhëna: sip. e parcelës ndërtimore/sheshit të ndërtimit: 121,4 m²; nr. i kateve mbi tokë: 3 kate; sipërfaqja shtesë që shfrytëzohet për banim: 395,3 m² (e ndarë në kate: kati përdhe 121,4 m²; kati i parë 139 m², papafingo 134,9 m²), ndërkohë që nga shkresa nr. {***} prot., datë 25.04.2018, e ALUIZNI-t Korçë, sip. faktike e bazës së ndërtimit rezulton të jetë 121,4 m².

15.3.1. Nga shkresa nr. {***} prot., dt. 26.8.2017, e Drejtorisë Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë (në vijim DRKK Korçë), rezulton se objekti është i formës 3 kate, kati përdhe është ndërtuar në vitin 1995 mbi shtëpinë ekzistuese të asaj kohe (1940 - 50), ndërsa kati i dytë + papafingo është ndërtuar në vitet 2002-2004. Objekti ka një sipërfaqe të gjurmës prej 139 m².

15.4. Nga aktet e administruara, deklarimi fillestar i vitit 2003 dhe shkresa nr. {***} prot., dt. 26.8.2017, e DRKK Korçë, përputhen të dhënat për fillimin e ndërtimit në vitin 1995, por për pjesën e përfundimit të tij ka një mospërputhje ndërmjet këtyre akteve, pasi subjekti deklaron se ndërtimi ka përfunduar në

⁸ Ka një ndryshim me 1 m² në sip. e ndërtesës së deklaruar respektivisht në deklaratën fillestare të vitit 2003 me deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit - vetting, në raport me kontratat e dhurimit: i) nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 9.7.2002 dhe ii) nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 12.7.2007, por që nuk është trajtuar si pasaktësi për shkak të vlerës minimaliste.

vitin 2002, ndërkohë që nga DRKK Korçë vlerësohet se, për katin e dytë dhe papafingon, ndërtimi mund të ketë zgjatur deri në vitin 2004.

15.5. Në kushtet kur nga aktet e mësipërme krijohet një mospërputhje e sipërfaqes së truallit dhe të ndërtesës në lidhje me përfundimin e ndërtimit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi me vlerë se prova e njohur si e tillë nga ligji nr. 84/2016 dhe që përbën deklaram të vetë subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”, ndërkohë që përfundimi i arritur nga DRKK Korçë është me bazë vlerësimi, duke u nisur nga gjendja faktike që është konstatuar në vitin 2017, shumë vite pasi ndërtimi ishte kryer, dhe jo konstatim i drejtpërdrejtë i ekzekutimit të punimeve ndërtimore. Gjykata çmon provat që ndodhen në akte, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre i rrethanave të çështjes.

15.6. Duke vlerësuar kryerjen e ndërtimit nga viti 1996 - 2002, Komisioni ka përgatitur analizën ekonomike duke e llogaritur në bazë të kostos mesatare të ndërtimit në raport me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit. Për llogaritjen e kostos së ndërtimit, Komisioni i është referuar vendimit nr. 13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit (k)”, nga ku ka konstatuar se kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 1997 është 16 138 lekë/m² për sipërfaqe ndërtimi.

15.6.1. Nga analiza ekonomike e Komisionit, ka rezultuar se kostoja e ndërtimit të banesës së subjektit të rivlerësimit llogaritet të jetë disa herë më e lartë se kostoja e deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit (6379.351⁹ lekë nga 2.500.000 lekë e deklaruar), dhe për të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjetet e nevojshme financiare (diferenca e pambuluar me të ardhura (-) 4010514¹⁰ lekë dhe pa përfshirjen e shpenzimeve për kosto jetese, dhe duke përfshirë likuiditetet e deklaruara *cash*, prej 1.500.000 lekësh, në deklaratën vjetore 2003). Diferenca mbetet e pambuluar edhe sikur të përfshiheshin në analizë të ardhurat nga paga e subjektit për vitet 1992 -1997 dhe të ardhurat nga pensioni i nënës, pasi këto vlera nuk bëjnë diferencë të madhe. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk u dukën bindëse për trupin gjykues të Kolegjit, pasi edhe sikur të mbahet në konsideratë fakti i deklaruar nga subjekti, se tullat janë marrë me një vlerë tepër të ulët dhe janë mbajtur për 5 vjet në shtëpi, çmimi i përcaktuar për ndërtimin e sipërfaqes shtesë është disa herë më i ulët se ai i përlllogaritur për ndërtimin e kësaj sipërfaqeje prej 395 m², sipas një çmimi mesatar të ndërtimit në vitin 1997. Ndërkohë që shtëpia, sipas shpjegimeve të subjektit, është ndërtuar deri në vitin 2002, pa u përcaktuar saktësisht koha. Edhe nëse e përlllogarisim koston e ndërtimit duke zbritur vlerën e tullave, përsëri ajo rezulton më e lartë se vlera prej 2.500.000 lekësh, e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Edhe sikur të konsiderohej deklarimi dhe pretendimi i tij në ankim, që ndërtimi është bërë në periudhën 1995 - 2002, e llogaritur sipas kostos së ndërtimit,

⁹ Shih pikën 33 të vendimit nr. 68, dt. 8.10.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

¹⁰ Shih rezultatet e hetimit paraprak, dt. 18.9.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

referuar udhëzimit nr. 21, datë 26.02.2009, të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2008, *Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme*”, kostoja minimale fiskale mesatare sipas viteve për ndërtesat e ndërtuara dhe regjistruara pas datës 1 janar 1995¹¹, për qytetin e Korçës, për metër katror, për këtë periudhë, është 22.935,63 lekë/m², pra më e lartë se vlera e llogaritur nga Komisioni. Për sa më sipër, sipas konstatimeve të trupit gjykues të Kolegjit për periudhën 1992 - 2003, duke konsideruar edhe pagat e periudhës 1992 - 1997 të subjektit të rivlerësimit¹², si dhe të ardhurat nga pensionet e nënës, duke përfshirë likuiditetet e deklaruara *cash*, prej 1.500.000 lekësh, në deklaratën vjetore 2003, dhe duke konsideruar vlerat sipas varianteve më sipër, subjekti rezulton në mungesë të burimeve të ligjshme, pa përfshirë këtu edhe shpenzimet për kosto jetese, të cilat do të thellonin edhe më tej pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme.

15.7. Të pabazuar e vlerëson trupi gjykues i Kolegjit, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ndërtimi i paligjshëm është kryer nga nëna e tij, pasi nga vetëdeklarimi për legalizimin e shtesës, datë 08.11.2006, i paraqitur në Drejtorinë e ALUZNI-t Korçë dhe nga deklarata noteriale nr. {***}rep., {***}kol., datë 04.11.2017, e depozituar për efekt të procesit të legalizimit, vërtetohet se ndërtimi i paligjshëm është kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit.

15.7.1. Sipas vetëdeklarimit për legalizimin e shtesës, datë 08.11.2006, vetëdeklaruesi Sotiraq Lubonja ka kërkuar legalizimin e një banese private, në lagjen {***}, rr. “{***}”, nr. {***}, Korçë, nr. i kateve 2,5, me gjendje faktike të përfunduar. Nga deklarata noteriale nr. {***} rep., {***}kol., dt. 4.11.2017, rezulton se z. Sotiraq Lubonja ka deklaruar: “Ndërtesa ekzistuese ka qenë me mure guri me baltë dhe në këtë ndërtesë kam bërë shtesa me sipërfaqe trualli, hedhje kati të dytë, plus papafingo”.

15.8. Irrelevant në këtë çështje është edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka shkelur nenin 199/1 të Kodit Penal, duke pretenduar se dispozita përkatëse ka hyrë në fuqi pasi ndërtimi i paligjshëm kishte mbaruar, dhe më tej sepse ligji penal përcakton veprat penale dhe dënimet kur është rasti, ndërkohë që në këtë çështje objekt shqyrtimi është justifikimi me burime të ligjshme i pasurisë së krijuar.

¹¹ Në udhëzim shprehet: “4. Pika 6.2 ndryshohet me këtë përmbajtje. Për ndërtesat e ndërtuara dhe të regjistruara pas datës 1 janar 1996 e në vitet në vijim, të cilat nuk kanë vlerë në blerje, për efekt të përcaktimit të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë, si vlerë minimale në blerje, do të merret kosto mesatare për 1m² të sipërfaqes së shfrytëzueshme, e përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave në: vendimet e Këshillit të Ministrave: VKM nr. 815, datë 9.12.1996; VKM nr. 13, datë 5.1.1998; VKM nr. 214, datë 28.04.1999; VKM nr. 362, datë 14.07.2000; udhëzimet e Kryeministrit nr. 5, datë 31.5.2001 dhe nr. 3, datë 16.10.2002; në udhëzimin e Kryeministrit nr. 1, datë 8.5.2003; nr. 1, datë 4.3.2004; nr. 5, datë 23.11.2005; nr. 5, datë 7.9.2006 dhe nr. 2, datë 4.4.2007 dhe udhëzimin e kryeministrit nr. 1, datë 20.8.2008, udhëzimin e kryeministrit nr. 2, datë 5.11.2008”.

¹² Sipas ligjit nr. 7668, datë 02.02.1993, “Për pagat e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe hetuesve. Ligji nr. 7800, datë 02.03.1994, “Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve”, VKM nr. 587, datë 25.10.1995, “Për disa ndryshime në pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve”, VKM nr. 236, datë 16.04.1996, “Për disa ndryshime në pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë dhe prokurorëve”.

15.8.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ligji penal i miratuar më vonë¹³, e ka bërë ndërtimin e paligjshëm, edhe penalisht të dënueshëm.

15.8.2. Për sa më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

- a) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën vjetore 2003 se zotëronte 108 m² truall, ndërkohë që sipërfaqja reale e truallit të zotëruar është 173 m²;
- b) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëronte 61 m², me dy kate + papafingo sip. ndërtimore, ndërkohë që sip. reale e ndërtimit të zotëruar është në total 395,3 m², dhe e ndarë në kate: kati përdhes 121,4 m², kati i parë 139 m², papafingo 134,9 m²;
- c) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e kostos së ndërtimit 2.500.000 lekë, ndërkohë që nuk arriti të provonte koston e pretenduar prej tij, për pasojë, në zbatim të standardeve të pranuarash tashmë në çështje të kësaj natyre, rezultojnë vlera të ndryshme nga ajo e deklaruar prej tij, dhe rezultoi që vlera e kostos së ndërtimit të kryer në vitet 1995 - 2002 ka qenë më e madhe dhe se subjekti i rivlerësimit kishte diferencë të pambuluar me të ardhura të ligjshme për këtë ndërtim, dhe për këtë arsye identifikohet të ketë pasuri më të madhe nga sa mund të justifikojë ligjërisht;
- ç) subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar në deklaratat periodike dhe *vetting* kërkesën për legalizimin e ndërtimit të paligjshëm dhe nga ana tjetër shprehet se ndërtimi është kryer nga nëna e tij.

*Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Sotiraq Lubonja ka kryer deklarim të rremë për sipërfaqen e shtëpisë së banimit, ndodhur në rr. “{***}”, Korçë, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “ç” e ligjit nr. 84/2016, ka bërë deklarim të pasaktë për vlerën e kësaj shtëpie banimi në Korçë, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “a” e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk justifikon me burime të ligjshme ndërtimin e kësaj shtëpie banimi në Korçë, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.*

16. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurime në vite në shumat 30.000 USD në vitin 2005 dhe në vitin 2015, 11.000 euro në vitin 2014 dhe 300.000 lekë në vitin 2015, si dhe shumën prej 500.000 lekësh në vitin 2017. Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë kryer udhëtime në ShBA, me vlerë 3.738.680 lekë sipas Komisionit, dhe sipas konstatimit në Kolegj 4.364.229 lekë (viti 2008, vitet 2010-2016, në total 20 udhëtime të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij). Në lidhje me udhëtimin në vitin 2008 së bashku me familjen në ShBA, udhëtimet gjatë viteve 2010 - 2016, së bashku apo veç e veç në ShBA, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për dhurimet e pretenduara si të përfituara nga personat e tjerë të lidhur, vjehri/vjehrra/kunati, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të konfirmojë marrëdhënien e dhurimit, por edhe ligjshmërinë e të

¹³ Ndryshuar me ligjet nr. 8175, datë 23.12.1996; nr. 8204, datë 10.4.1997; nr. 8279, datë 15.1.1998; nr. 8733, datë 24.1.2001; nr. 9017, datë 6.3.2003; nr. 9030, datë 13.3.2003; nr. 9086, datë 19.6.2003; nr. 9188, datë 12.2.2004; nr. 9275, datë 16.9.2004; nr. 9686, datë 26.2.2007; nr. 9859, datë 21.1.2008; nr. 10 023, datë 27.11.2008; nr. 23/2012, datë 1.3.2012; nr. 144, datë 2.5.2013; nr. 98, datë 31.7.2014; nr. 176/2014, datë 18.12.2014; nr. 135/ 2015, datë 5.12.2015; nr. 82/2016, datë 25.7.2016; nr. 36/2017, datë 30.3.2017; nr. 89/ 2017, datë 22.5.2017; vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 13, datë 29.5.1997; nr. 46, datë 28.8.1997; nr. 58, datë 5.12.1997; nr. 65, datë 10.12.1999; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 19, datë 1.6.2011; nr. 47, datë 26.7.2012 dhe nr. 9, datë 26.2.2016.

ardhurave të dhuruara sipas nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, me qëllim për të përmbushur detyrimin që ai vetë ka për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Dispozita kushtetuese urdhëron drejtpërdrejt subjektin e rivlerësimit për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, ligjshmëri e cila shtrihet edhe në drejtim të të ardhurave të dhuruara.

16.1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vjehri, z. G. Gj., ka derdhur në {***} Bank , në llogarinë e bashkëshortes së tij shumën 25000 USD.

16.1.1. Nga akti veprim arke, datë 13.6.2005, i {***} Bank, rezulton e depozituar nga z. G. Gj. në favor të znj. M. L. shuma prej 25000 USD. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se ky veprim financiar ekuivalentohet nga pikëpamja juridike në kuptim të ligjit nr. 84/2016 me përcaktimet e nenit 32, pika 4, si një veprim konkludent që ka çuar në një marrëdhënie dhurimi midis subjektit dhe personit tjetër të lidhur, z. G. Gj. (vjehri i tij), fakt ky i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vjetore 2005 dhe në deklaratën *vetting*. Z. G. Gj. gjendej në pamundësi financiare për dhurimin e kësaj shume në vitin 2005, pra shuma prej 25000 USD nuk justifikohet me burime të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pensionet ndër vite, përfshirë dhe pensionin suplementar të vjehrit¹⁴, nga tetori 1999 kur janë larguar në ShBA deri në maj 2005, që është momenti i dhënies së dhurimit më 13.06.2005, rezultojnë në vlerën e përafërt prej 1.613.936 lekësh, dhe për këtë arsye duket që të ardhurat nga pensioni *nuk mbulojnë* vlerën e dhurimit prej 2.559.500 lekësh (ekuivalenti i shumës 25.000 USD, konvertuar me kursin e datës 13.06.2005, sipas publikimeve zyrtare në Bankën e Shqipërisë).

16.1.2. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit konstaton dhe vlerëson se nëpërmjet veprimit konkludent të arkëtimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurim për të cilin nuk justifikoi me dokumentacion ligjshmërinë e burimit dhe se personi tjetër i lidhur nuk kishte burime të ligjshme financiare për të kryer këtë dhurim, rrethanë e cila çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën prej 25000 USD. Nga dokumentacioni i paraqitur për vjehrin e subjektit, sipas konstatimit edhe të ILDKPKI-së, z. G. Gj., me banim në ShBA që nga viti 1999, nuk ka provuar mundësinë e tij financiare për shumën e depozituar fillimisht në {***} Bank prej 25000 USD, në emër të vajzës së tij.

¹⁴ *Shih: vërtetim ISSh nr. {***} prot., dt. 02.07.2018, dërguar Komisionit, për G. Gj., pension nga 20.05.1998 e vazhdim, deri më 30.06.2018, shuma e të ardhurave totale është 2.501.996 lekë; vërtetim ISSh nr. {***} prot., dt. 02.07.2018, dërguar Komisionit për P. Gj., pension nga 29.06.1993 e vazhdim, deri më 30.06.2018, shuma e të ardhurave është 2.670.640 lekë; vërtetim ISSh nr. {***} prot., dt. 27.09.2018, sjellë nga subjekti Komisionit me e-mail, dt.28.09.2019, pension suplementar nga 01.01.1999 e vazhdim, deri më 30.08.2018, shuma e të ardhurave është 1.060.442 lekë.*

16.2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, është deklaruar se djemtë e tij, z. P. L. dhe z. I. L., kanë çelur depozitë më datë 22.08.2014 pranë Bankës {***}, secili nga 5500 euro, në total 11.000 euro, me burim krijimi të ardhura nga gjyshi, z. G. Gj.

16.2.1. Nga deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***}kol., datë 26.08.2014, rezulton e deklaruar nga z. G. Gj. se në datë 22.8.2014 ka çelur një depozitë bankare në emër të nipit P. S. L. pranë Bankës {***}, Dega Korçë, në vlerën prej 5500 eurosh dhe se po më këtë datë, 22.8.2014, ka çelur një depozitë bankare në emër të nipit I. S. L. pranë Bankës {***}, Dega Korçë, në vlerën prej 5500 euro dhe se kjo vlerë monetare është siguruar nga pensioni i tij në Shqipëri që nga viti 1999 kur është larguar për në ShBA. Nga veprimi arkëtim në llogari i Bankës {***}, rezulton çelje depozite dhe depozitim nga z. G. Gj. për llogari të z. P. L. në shumën 5500 euro. Nga veprimi arkëtim në llogari i Bankës {***}, rezulton çelje depozite dhe depozitim nga z. G. Gj. për llogari të z. I. L. në shumën 5500 euro. Subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me dokumentacion ligjshmërinë e burimit të pasurive të deklaruara si dhurata dhe nuk u provua se personi tjetër i lidhur, z. G. Gj., të ketë pasur burime financiare për këtë depozitim arke.

16.3. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, është deklaruar dhurim nga gjyshi, z. G. Gj., për djemtë, z. P. L. dhe z. I. L., me deklaratën noteriale (mbajtur në ShBA), datë 25.08.2015, në vlerën 2500 USD secilit, në total 5000 USD.

16.3.1. Nga deklarata noteriale e datës 25.08.2015, rezulton e deklaruar: “unë i nënshkruari G. Gj., në pamundësi të vij në Shqipëri për veprime ligjore administrative dhe financiare, deklaroj me vullnetin tim të lirë se ju dhuroj nga 2500 dollarë amerikanë secilit prej nipave të mi [...]”.

16.3.2. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurim për të cilin nuk justifikoi me dokumentacion ligjshmërinë e burimit, se personi tjetër i lidhur, z. G. Gj., ka pasur burime të ligjshme financiare për të kryer këtë dhurim, pasi nuk rezultoi të jenë provuar mjaftueshëm të ardhurat¹⁵, shpenzimet apo kursimet e familjes Gj. në ShBA (duke konsideruar këtu edhe udhëtimin e qëndrimin në ShBA të personave të bashkëshortes dhe fëmijëve për periudhën 31.07.2015 - 31.08.2015), rrethanë e cila çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumën prej 5000 USD.

16.4. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve, ka deklaruar se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimin në ShBA, për periudhën 2008 – 2016, janë paguar nga vjehri, vjehra, si dhe kunati. Sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni, këto shpenzime janë përlllogaritur në vlerën 3.738.680 lekë, dhe sipas konstatimit në Kolegj 4.364.229 lekë (viti 2008, vitet 2010 -2016, në total 20 udhëtime të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij).

¹⁵ Referuar dokumenteve në dosjen e Komisionit, rezultojnë lëvizje të llogarisë së z. G. Gj., në të cilat vihen re të ardhura nga paga, payroll dhe hyrje nga {***} për 2015, nga 01.01.2015 deri më 28.08.2015, në shumën 13.249 USD.

16.4.1. Për këto shpenzime nuk provohet fakti që janë kryer e përballuar prej këtyre shtetasve me qëllim për të përmbushur detyrimin që ai vetë ka, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive. Në dosjen e Komisionit, për subjektin e rivlerësimit nuk ka akt/veprim me të cilin provohet apo konfirmohet marrëdhënia e mbulimit të shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit nga bashkëshortja e kumatit të subjektit, znj. A. Gj., gjenden vetëm komunikime elektronike (*e-mail*) që janë dërguar nga A. dhe A. Gj., me përmbajtje të rezervimit të biletës, të cilat nuk tregojnë në përmbajtje të tyre se nga cilat llogari janë paguar biletat.

16.5. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nuk provohet fakti i mbulimit të këtyre shpenzimeve rrugëtimi në ShBA, që janë kryer prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, rrethana këto të cilat çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar këto shpenzime udhëtimi në ShBA, në vlerën 3.738.680 lekë. Nuk rezulton të jenë provuar mjaftueshëm të ardhurat, shpenzimet apo kursimet e familjes Gj. në ShBA. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhurim për të cilin nuk u provua bindshëm se personat e tjerë të lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për të kryer këtë dhurim, fakt i cili bie ndesh me detyrimin që ka për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të këtyre shpenzimeve, rrethana të cilat çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në ShBA (në vlerën 3.738.680 lekë, sipas metodologjisë së Komisionit).

- 17.** Në lidhje me dhurimet dhe mjetet financiare të nënës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se veprimet e dhurimit të pretenduara si të kryera nga nëna e subjektit të rivlerësimit dhe mjetet financiare të pretenduara, si administratore e njësisë ekonomike familjare, nga deklaratat fillestare dhe periodike e pasurive, rezultojnë sa më poshtë.
- a) Në deklaratën fillestare të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën 1.500.000 lekë, me burim krijimi "kursime dhe lekë, të dhëna nga nëna, dhurim".
 - b) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera e doganës, prej 325.000 lekësh, për blerjen e makinës tip "Mercedes Benz", është paguar nga nëna në formë dhurimi.
 - c) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nëna, para vdekjes, në datën 20.9.2012, i ka lënë shumën 3.000.000 lekë.
 - ç) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nëna ka pasur bono privatizimi 6 x 40000, 5 x 20000, 1 x 15000, gjithsej 355.000 lekë.

Subjekti rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues mbi likuiditetet e nënës, sipas nenit 32, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, ndërsa nga analiza ekonomike mbi të ardhurat e deklaruara për nënën (pensionin), trupi gjykues vlerëson se nuk rezulton i mundur kursimi i shumës prej 1.500.000 lekësh, nga kursimet e subjektit dhe dhurimet e nënës së tij.

17.1. Subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me dokumentacion mundësinë e kursimit nga njësi ekonomike familjare, e administruar nga nëna e tij, sipas pretendimit dhe cilësimit të tij, duke

mbajtur në konsideratë faktin se edhe vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar (në deklaratimet vjetore periodike) kursime familjare ndër vite nga të ardhurat. Nëna e subjektit të rivlerësimit ka qenë në pamundësi për realizimin e të ardhurave të deklaruara të kursyera, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se deri në vitet 2002-2003, të ardhurat familjare kanë shërbyer tërësisht për ndërtimin e shtëpisë në Korçë. Siç është arsyetuar më sipër për pasurinë shtëpi banimi, ndodhur në rr. “{***}”, Korçë, për periudhën e analizuar 1992-2003, subjekti rezulton në mungesë të burimeve të ligjshme, duke përfshirë në analizë edhe likuiditetet e deklaruara *cash* prej 1.500.000 lekësh në deklaratën vjetore 2003. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se njësia ekonomike familjare, e cila sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit administrohej nga nëna e tij, gjendej në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për t’i realizuar këto kursime (të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si “dhurime”), rrethanë e cila çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumat e pretenduara si të dhuruara.

18. Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të vlerës së blerjes së automjetit tip “Mercedes Benz”, prodhim i vitit 1999, blerë më datë 14.04.2005, vlera 900.000 lekë + 325.000 lekë taksë doganore, pjesa që zotëron subjekti i rivlerësimit 100 %, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, nga deklarata periodike vjetore e vitit 2005, rezulton e deklaruar se me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2005, subjekti i rivlerësimit ka blerë një makinë të tipit “Mercedes Benz”, në shumën 900.000 lekë, plus 325.000 lekë taksë doganore, paguar nga nëna si dhuratë.

18.1. Nga analiza e situatës financiare për vitin 2005, rezulton se njësia ekonomike familjare e cila, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, administrohej nga nëna e tij (të ardhurat e familjes, duke përfshirë dhe të ardhurat nga pensioni i saj), nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e makinës, pasi likuiditetet e krijuara dhe shpenzimet e bëra gjatë këtij viti, në këtë analizë, nuk janë të mjaftueshme, dhe shuma prej 544.636 lekësh përbëhet nga shpenzime të deklaruara të pajustificuara me të ardhurat e vërtetuara nga Komisioni. *Referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se blerja e makinës është produkt i viteve të punës nga viti 1985 dhe deri në momentin e blerjes së makinës*, duke konsideruar se analiza ekonomike është e shtrirë ndër vite dhe ajo pasqyron të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet ndër vite të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke konsideruar që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndryshime të likuiditeteve (*cash*) në këto vite, dhe për sa kohë që subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri burimesh për ndërtimin e shtëpisë së ndodhur në rr. “{***}”, Korçë (sipas arsyetimit më sipër) dhe për krijimin e likuiditeteve *cash* në shumën 1.500.000 lekë (të deklaruara në vitin 2003 si “kursime dhe lekë, të dhëna nga nëna, dhurim”), trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka likuiditete të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie.

18.2. Subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe, për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se njësia ekonomike familjare gjendej në mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të realizuar këto kursime, dhe se këto rrethana çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të

justifikojë ligjërisht, dhe se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shumat: i) 900.000 lekë; dhe ii) 325.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton gjithashtu se analiza financiare për krijimin e kësaj pasurie, në analizën e kryer në Komision, përfshihen të ardhurat e krijuara për gjithë vitin 2005. Rezulton se pasuria është krijuar në muajin e katërt (prill) të vitit 2005, por nga ana tjetër në analizë janë përfshirë edhe të ardhurat e krijuara pas datës së krijimit të pasurisë (blerje makine, datë 14.04.2005), rrethanë që do të thellonte edhe më tepër mungesën e burimeve të ligjshme financiare.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Sotiraj Lubonja nuk justifikon me burimeve të ligjshme blerjen në datën 14.04.2005, të automjetit “Mercedes Benz”, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nëna, para vdekjes (20.09.2012), i ka lënë shumën 3.000.000 lekë. Trupi gjykues i Komisionit nuk u bind për të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke i konsideruar si mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar vlerat financiare të dhuruara nga nëna, e cila rezulton të ketë pasur probleme shëndetësore, dhe të ketë marrë ndihma financiare nga familjarët e saj (vëllai dhe motra). Mbështetur në analizën financiare, të kryer nga Komisioni, rezulton se nëna ka qenë në pamundësi për realizimin e të ardhurave të deklaruara të kursyera, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se deri në vitet 2002-2003, të ardhurat familjare kanë shërbyer tërësisht për ndërtimin e shtëpisë në Korçë, po ashtu edhe faktin se vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime ndër vite. Në vijim të arsyetimit më sipër, edhe sikur të konsideroheshin pretendimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 – 1997, për të cilat gjithsesi subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion, siç është analizuar më sipër për pasurinë shtëpi banimi, ndodhur në rr. “{***}”, Korçë, përfshirë dhe pensionet e nënës si administratore e njësisë ekonomike familjare, duke filluar që nga viti 1992, njësia ekonomike familjare nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ndërtimin e shtëpisë, për krijimin e likuiditeteve *cash* në shumën 1.500.000 lekë (të deklaruara në vitin 2003 si “kursime dhe lekë, të dhëna nga nëna, dhurim”), për blerjen e automjetit në shumën 1.225.000 lekë në vitin 2005, për shpenzimet nga udhëtimet TIMS të deklaruara në pyetësor, për mobilim e pushime, konsideruar dhe pasuritë e likuiditetet e krijuara gjatë kësaj periudhe, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka likuiditete të mjaftueshme për krijimin e këtij kursimi.

18.3. Për krijimin e likuiditeteve bono thesari, konstatohet se si burim për krijimin e tyre ka shërbyer: i) dhurimi prej 25.000 USD nga z. G. Gj., depozituar më datë 13.06.2005, në llogarinë personale të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. M. L., pranë {***} Bank, vlerë të cilën znj. M. L. e ka kaluar në vitin 2007 në bono thesari (deklaruar 3.000.000 lekë); ii) vlera 3.000.000 lekë, e lënë (pretenduar si kursime të njësisë ekonomike familjare) para ndarjes nga jeta nga nëna e subjektit të rivlerësimit, më datë 20.09.2012, shumë të cilën znj. M. L. e ka kaluar në bono thesari në vitin 2013; dhe iii) pjesa tjetër e bonove të thesarit (9.150.000 lekë - 6.000.000 lekë = 3.150.000

lekë), nga kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, znj. M. L., në vite¹⁶. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, duke qenë se për burimin e krijimit të *bonove të thesarit* pjesërisht pretendohet se kanë shërbyer disa nga kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit të atribuuar nënës si administratore e njësisë ekonomike familjare dhe dhurimeve nga vjehtëri i tij, për të cilat trupi gjykues i Kolegjit ka vlerësuar më lart se nuk u justifikua ligjshmëria e burimit të tyre, rrjedhimisht në përfundim konkludohet se krijimi i pasurisë bono thesari është realizuar me të ardhura të pajustificuara.

Sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Sotiraq Lubonja ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar dhurimet të cilat kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë bono thesari dhe përballimin e shpenzimeve jashtë shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pretendimet e tjera me përmbajtje ankimi të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 68, datë 08.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se në tërësinë e tyre nuk janë relevante për objektin e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes në Komision. Ky konkluzion i Kolegjit çmohet i tillë për shkakun se Komisioni është investuar, ka marrë në analizë, në shqyrtim dhe ka disponuar në fund të hetimit vetëm për një kriter rivlerësimi, siç është kriteri i pasurisë, ndërsa për dy kriteret e tjera, figura dhe profesionalizmi, Komisioni ka filluar dhe përfunduar hetimin pa pasojën e shkarkimit. Këtë proces Kolegji e gjen të drejtë dhe të bazuar në ligj, konkretisht në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën parashikohet qartësisht se Komisioni ose Kolegji, si organe që vendosin për rivlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit marrin vendim bazuar në një nga kriteret e rivlerësimit. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisioni është marrë mbi bazën e një hetimi administrativ të paplotë dhe të pabazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, është pretendim i njëanshëm, i paprovuar dhe vjen në kundërshtim me faktet dhe procedurën e provuar në dosje. Rezulton nga këto akte se hetimi ka qenë i plotë, nisur për të tria kriteret e rivlerësimit, dhe vendimmarrja e bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pra vetëm për një kriter, siç është ai i pasurisë. Vendimi nr. 68, datë 08.10.2018, i Komisionit është i pacenueshëm, çka përbën edhe një nga arsyet se përse ai duhet të lihet në fuqi.

Vendimi përmban qartësisht bazën ligjore mbi të cilën është dhënë zgjidhja e çështjes dhe konkretisht u është referuar parashikimeve dhe urdhërimeve të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pra, baza ligjore e vendimmarrjes është e plotë dhe pasoja lidhur me shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është në respektim të plotë të përcaktimeve ligjore dhe shkaqeve të parashikuara në to.

Arsyetimi i vendimit është në lidhje organike dhe unitare me dispozitivin e vendimit, pra subjekti i rivlerësimit është dëgjuar drejt, në kuptim të jurisprudencës kushtetuese, duke i dhënë mundësinë

¹⁶ Duke përfshirë këtu si pjesë të kursimeve cash shumë 1.400.000 lekë, të investuar në bono thesari në vitin 2015, të deklaruar në deklaratën vetting si pjesë të shumës prej 1.500.000 lekësh, deklaruar në deklaratën vjetore 2003 si “kursime dhe lekë, të dhëna nga nëna dhurim”, trajtuar më lart në vendim).

e qartë ta kundërshtojë atë me mjetin ligjor të ankimit, brenda afateve ligjore dhe në një organ kushtetues garant, sikurse është Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Komisioni nuk ka shpjeguar në mënyrë të përsëritur çfarë është shprehur nga ILDKPKI-ja në raportin e saj, por në mënyrë të detajuar, të plotë dhe të gjithanshme ka bërë hetim për vlerësimin e pasurisë së subjektit në të gjitha asetet e deklaruar dhe të verifikuara nëpërmjet procesit të rivlerësimit në këtë institucion kompetent. Komisioni ka verifikuar, hetuar dhe vlerësuar të gjitha deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për këtë kriter të rivlerësimit, i ka komunikuar palës, subjektit, rezultatet përfundimtare të hetimit, i ka kaluar barrën e provës për ato asete që ka çmuar se kërkonin shpjegime shtesë nga subjekti, i ka garantuar të drejtën e dëgjësës publike po subjektit, si dhe të drejtën e aksesit të njohjes me dosjen, provat përkatëse dhe të drejtën e kundërshtimit të tyre. Me këtë procedurë, subjektit i është garantuar e drejta e mbrojtjes aktive dhe efektive në këtë proces administrativ të hetimit ndaj tij. Komisioni ka arsyetuar në mënyrë logjike dhe me argumente të bazuara në prova dhe në faktet evidente të administruara në dosje.

18.4. Pas shqyrtimit të çështjes, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit:

- a) ka kryer deklarin të rremë për sipërfaqen e shtëpisë së banimit, ndodhur në rr. “{***}”, Korçë, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “ç” e ligjit nr. 84/2016;
- b) ka bërë deklarin të pasaktë për vlerën e kësaj shtëpie banimi në Korçë, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “a” e ligjit nr. 84/2016;
- c) nuk justifikon me burime të ligjshme ndërtimin e kësaj shtëpie banimi në Korçë, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “b” e ligjit nr. 84/2016;
- ç) nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen në datën 14.04.2005 të automjetit “Mercedes Benz”, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “b” e ligjit nr. 84/2016;
- d) ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar dhurimet të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë bono thesari dhe përballimin e shpenzimeve jashtë shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 33/5, pika “b” e ligjit nr. 84/2016.

18.5. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

- 19.** Në përfundim të gjithë sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se vendimi nr. 68, datë 08.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, unanimisht, bazuar në nenin 66/1, pika “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 68, datë 08.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Sotiraq Lubonja.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 08.10.2019.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Luan DACI

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi